



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ANGLEZE



PROGRAMI I LËNDËS 2023-2024

Laborator Praktik dhe Teorik për Shkrimin e Temës Përfundimtare

Titullari /pedagogu i lëndës (për programet profesionale): Prof. Dr. Daniela Tamo, Prof.Asoc. Adriana Dervishaj, Dr. Vjollca Tabaku

Ngarkesa: 6 ECTS, 60 orë në klasë: 30 orë leksione, 30 orë seminare

Viti akademik, semestri kur zhvillohet: Viti II, Semestri I

Lloji i lëndës: e detyrueshme

Programi i studimit: Master i Shkencave, Mësuesi në Gjuhë Angleze për Arsimin e Mesëm të Lartë

Adresa elektronike e titullarit/e pedagogut të lëndës: daniela.tamo@unitir.edu.al, adriana.dervishaj@unitir.edu.al, vjollca.tabaku@unitir.edu.al

Kodi i Etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 5, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Kjo lëndë zhvillohet në ciklin Master në Mësuesi me studentët e vitit të dytë. Ajo ofron materiale teorike dhe praktike për t'u mësuar studentëve të konceptojnë dhe shkruajnë temën e tyre në përfundim të studimeve të masterit. Lënda synon të ofrojë një trajtim të gjerë të procesit të shkrimit të temës së masterit, të hapave konkretë që merren për shkrimin e temës së masterit dhe të doktoratës. Vend të veçantë zënë temat për kapitujt përbërës, elementët përbërës të tyre, mënyrën e organizimit të këtyre elementëve. Po ashtu, stili i përdorur në shkrimin e temës është shumë i rëndësishëm.

Në fund të këtij kursi, studentët janë të aftë të:

1. forcojnë njohuritë e tyre për procesin e shkrimit;
2. organizojnë si duhet kapitujt e temës;
3. analizojnë të dhënat sasiore dhe cilësore,
4. përmbledhin, perifrazojnë;
5. citojnë si duhet;
6. shkruajnë përfundime të mira;
7. përdorin stilin akademik dhe formal;
8. përdorin tabelat, grafikët, figurat etj.

KONCEPTET THEMELORE:

1. Shkrimi i temës së Masterit

2. Platformë
3. Shqyrtimi i literaturës
4. Metodologjia
5. Rezultatet
6. Diskutimi i rezultateve
7. Përfundimet
9. Abstrakti
10. Pyetësori
11. Intervista
12. Kampioni
13. Studim cilësor
14. Studim sasior